

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	10.09.2025	Informacion mbi procedurën e rinovimit të kërksës së kredise.	17.09.2025	Kërkesa për shtyrje afati për Subvencionimin e interesave të kredisë me 3%, duhet bërë në portalin qeveritar e-albania, në rubrikën "Shtyrje afati kredie me 3%".	Përfunduar. Kthim përgjigje me email.	Nuk ka

1 Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

2 Data e regjistrimit të kërkesës

3 Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

4 Data e kthimit të përgjigjes

5 Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

6 Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

7 Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti pub

2	08.09.2025	Kërkesë për informacion mbi pagesat vullnetare të sigurimeve shoqërore	16.09.2025	Sipas nenit 3, të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Rregullores Nr. 4, datë 25.05.2009, “Për sigurimin vullnetar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore”, parashikohet mbulimi me sigurim shoqëror vullnetar si vijon: Shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe që nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar; Shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhën e studimeve universitare, me kusht që personi i siguruar të paguajë kontribut për këtë periudhë, përpara datës së fillimit të së drejtës për të ardhura; Shtetasit shqiptarë që kanë periudha të pambuluara nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm brenda dhe jashtë vendit, të cilët dëshirojnë t’i plotësojnë ato	Përfunduar. Kthim përgjigje me emailim	Nuk ka
---	------------	--	------------	---	--	--------

				nëpërmjet sigurimit vullnetar; Personat që kanë lënë shtetësinë shqiptare, për mbulimin e periudhave të kaluara nga data 01.01.1994, deri në datën që kanë lënë shtetësinë. Për qëllimet e pranimi në sigurimin vullnetar, nëse parashikohet nga legjislacioni i njërit prej shteteve kontraktuese, periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të atij shteti grumbullohen, nëse është e nevojshme, me periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, me kusht që ato të mos mbivendosen dhe sipas dispozitave të parashikuara nga legjislacioni i secilit shtet. Regjistrimi i njëkohshëm në sigurimin e detyrueshëm të një shteti kontraktues dhe sigurimin vullnetar të shtetit tjetër lejohet vetëm në rast se një mundësi e tillë lejohet nga legjislacioni i këtij të fundit.		
--	--	--	--	--	--	--

3	08.09.2025	Kërkesë për informacion nga Jamie Eïseman Europe Advocacy Officer international press institute (ipi) Lidhur me ekzekutimin e masës së sigurimit të padisë për “Focus Media Neës” sh.p.k	08.09.2025	Bazuar në rrethanat e ligjore dhe jurisprudencën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka qenë dhe mbetet e hapur të mbajë komunikim me shoqërinë “Panorama Group” sh.a., për adresimin e çdo pretendimi të saj, në respekt të shtetit të së drejtës dhe të garantimit të interesave të patjetërsueshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e pronës shtetërore.	Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë zyrtare.	Nuk ka
---	------------	--	------------	--	---	--------

	24.09.2025	Kërkesë për informacion lidhur me lejet e zakonshme, raportet mjkoligjore si dhe lejet pa të drejtë page	01.10.2025	Informacion i percjellur ne forme tabelare me informacionet e kërkuara për lejet dhe raportet mjekosre për vitet 2023,2024 dhe 2025(periudha 1 Janar -15 Maj).	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka
4	17.09..2025	Kërkesë për informacion nga Shoqëria Alb Bakër sh.a	19.09.2025	Shoqëria Alb-Baker nuk disponon asnjë dokumentacion të ish Miniserës së Bakrit..	Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë zyrtare.	Nuk ka
5	02.10.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të kontartës së shitjes ndërmjet shoqërisë “Petrol Alba” dhe shoqërisë Këlcyra 2020 sh.p.k për pronënë e ndodhur në zonën kadastrale nr. 2170	03.10.2025	Në vijim të kërkesës për venien në dispozicion të kontratës së shitjes ndërmjet shoqërisë "Petrol Alba" sh.a. në likuidim dhe shoqërisë "Kelcyra 2020" SHPK për pronën e ndodhur në Zonen Kadastrale nr. 2170, Volumi 46, Faqe 96, Tropojë, janë informuar se dokumenti i kërkuar ndodhet në administrimin e MEKI-t. Në zbatim të Ligjit Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Ligjit Nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" informacioni që mund të vihet në dispozicion është ai	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka

				i publikuar tashmë në faqen e Agjensisë së Prokurimit Publik.		
6	07.10.2025	Kërkesë për Informacion mbi procesin për njohjen e diplomës së arsimit profesional	08.10.2025	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit kryen vetëm njohjen dhe njësimin e kualifikimeve profesionale të niveleve II deri në IV të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). (Pra njihet vetëm kualifikimi i marrë në këtë nga shkollimi) Procedura e njohjes bazohet në Udhëzimin Nr. 24, datë 30.07.2018 , “Për njësimin e mësim-nxënies dhe kualifikimeve profesionale me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, përfshirë ato të përfituara jashtë vendit”.(bashkëlidhur këtij emali) Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për të nisur procedurën, e njohjes se kualifikimit të marre është sipas parashikimeve ligjore.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka

7	15.10.2025	Informacion për aplikim për kredi	16.10.2025	Persa i perket kushteve qe duhen plotesuar dhe dokumentacionit qe nevojitet per te aplikuar dhe per te perfituar nga ky program, duhet t'i referoheni nenit 64/1 te ligjit nr.22/2018 “Per Strehimin Social”, i ndryshuar, si dhe VKM Nr.468, date 26.7.2023, "Per trajtimin me kredi te lehtesuar te te punesuarve ne administraten publike per blerjen e banesesh". Dokumentacionin duhet te dorëzohet ne menyre elektronike ne momentin e aplikimit në portalin unik qeveritar “e-Albania” ne linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15809 Në vijim, referuar përcaktimeve ligjore sa më sipër, ju mund te aplikoni per te përfituar nga programi i kredisë së lehtesuar per administraten publike në momentin që do të hapet programi per vitin 2026 dhe do behet shpallja e linkut aktiv.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka
---	------------	-----------------------------------	------------	--	--	--------

8	16.10.2025	Informacion mbi shpronësimet e disa familjeve në Durrës	16.10.2025	Ky projekt është ndjekur nga Bashkia Durrës	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka
9	22.10.2025	Kërkesë për informacion mbi statusin e diplomës profesionale				
10	23.10.2025	Kërkesë për informacion mbi grevën e punëtorëve të kompanisë “Bankers Petroleum”	27.10.2025	Përgjigje: Zyra Rajonale e Punës (AKPA) Fier dhe strukturat përkatëse të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit kanë ndërmarrë dhe parashikojnë masat e mëposhtme: Zbatimin rigoroz të procedurave ligjore të parashikuara në Kodin e Punës dhe Udhëzimin nr. 13, datë 12.05.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave për ndërmjetësimin dhe pajtimin e konflikteve kolektive të punës, si dhe procedurat përkatëse”, për zhvillimin e ndërmjetësimit/pajtimit; · Sigurimin e një procesi të paanshëm dhe transparent, duke garantuar	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka

				përfaqësimin e të dyja palëve; · Nxitjen e dialogut social si mjet parësor për parandalimin dhe zgjidhjen me mirëkuptim të konflikteve të punës; · Monitorimin e situatës dhe informimin e vazhdueshëm të institucioneve përgjegjëse për ecurinë e procesit;		
11	29.10.2025	Kërkesë për informacion mbi inspektimet që janë bërë në Minierën e Bulqizës	05.11.2025	Kthyer përgjigje nga ISHPSHSH	Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë zyrtare	Nuk ka
12	04.11.2025	Kërkesë për informacion për aplikim për kredi Bashkia Pogradec				
13	10.11.2025	Kërkesë për informacion mbi programin Kombëtar të Strehimit Social	18.11.2025	Thirrja per projektet e Strehimit per vitin 2026 nuk eshte hapur ende, por si cdo vit thirrja do te hapet ne fillim te vitit qe vjen per te gjitha bashkite ne rang vendi.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka

14	17.11.2025	Këresë për informacion mbi disa probleme të banorëve lidhur me rindërtimin	21.11.2025	Në zbatim të përcaktimeve të fushës së përgjegjësisë shtetërore, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka
15	27.11.2025	Kërkesë për informacion mbi problematikat e banorëve të vorës të prekur nga tërmeti	09.12.2025	Në zbatim të përcaktimeve të fushës së përgjegjësisë shtetërore, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka
16	16.12.2025	Kërkesë për informacion mbi Planin e Rritjes, nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim		Presim përgjigje datë 29 dhjetor 2025		

